



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:103015

Datë: 12.04.2024

Numri i dokumentit: 05575560

KF.nr.325/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal, me gjyqtaren Vera Gashi Bala, në kontestin tregtar - administrativ të paditësit “Mercur Automat Klub-Ks” Sh.P.K., me numër fiskal 601675864 dhe seli në Magjistralen Prishtinë-Ferizaj, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Islam Musa avokat në Ferizaj, kundër të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës, lidhur me padinë e paditësit për anulimin e vendimit të ATK-së nr.66/2021 të datës 02.04.2021, në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor publik, të mbajtur në prani të avokatit të palës paditëse Islam Musa, dhe në prani të përfaqësuesit të palës së paditur Artan Krasniqi, me datë 02.04.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET kërkesëpadia e paditësit “Mercur Automat Klub-Ks” Sh.P.K., me seli në Magjistralen Prishtinë-Ferizaj, të cilin e përfaqëson Islam Musa avokat, si e bazuar.
- II. ANULOHET vendimi nr.66/2021 i datës 02.04.2021, i Departamentit të Ankesave i Administratës Tatimore të Kosovës dhe lënda kthehet në RISHQYRTIM DHE RIVENDOSJE tek e paditura.
- III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi me padinë e paraqitur në Gjykatë, me datë 27.05.2021, ka iniciuar kontestin tregtar-administrativ kundër të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës, me të cilën ka kërkuar anulimin e vendimit nr.66/2021 të datës 02.04.2021. Përfaqësuesi i palës paditëse në seancën e datës 02.04.2024 ka deklaruar se ngelin në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë, e

paditura ATK me seli në Ferizaj ka hartuar draft raportin e ri kontrollës me datë 24.11.2020 duke u bazuar në listën e verifikimit të automateve në depo të biznesit 03.03.2020. Ka theksuar se në raportin të ri kontrollimit përpiluar nga inspektori tatimor nga tabela e qarkullimit shtesë është 821,346.38 Euro dhe tatimi shtesë është 82,136.44 Euro, këtë vlerë duke e aplikuar ndëshkimin prej 25 % për shmangie tatimore në vlerë prej 20,534.11 euro, me këtë raport gjatë evidentimit janë bërë gabime teknike të numrit serik të aparaturës dhe numrit mekanik të aparaturave. Tutje ka theksuar se aparatet siç dihet kanë numrin serik, mekanik dhe elektronik mirëpo gjatë evidentimit të këtyre aparateve inspektorati i kanë lexuar dy numra dhe kjo vërtetohet nga lista e verifikimit të aparateve në depo të biznesit të datës 03.03.2020 ku në atë raport vërejmë se zyrtarët e ATK-së kanë shënuar 82 aparate ndërsa në realitet janë vetëm 80 aparate, për arsye se numri rendor të listës së verifikimit dhe atë numri 43 dhe 56 shihet qartë se është i njëjti numër serik (314540052) dhe në realitet është 3145400550 e njëjta ka ndodhur me numrin rendor 101074 që kanë të njëjtin numër serik të cilët janë dhënë në listën e konfiskimit të përkohshëm nga Policia e Kosovës dhe Prokuroria e Shtetit, këto të papërdorshme kanë qenë të vendosura në një depo në rr. “Driton Islami” në Ferizaj, kanë qenë të bllombuara nën mbikëqyrjen e Doganës së Kosovës dhe çelësat e kësaj depo i ka poseduar ATK-ja dhe nuk ka mundur paditësi të ketë qasje pa lejen e Doganës dhe ATK-së. I ka propozuar gjykatës që në cilësinë e dëshmitarit të ftohet V.M. nga Prizreni i cili ka qenë administrator dhe menaxher i kësaj kazinoje dhe detajisht mund ta informoj gjykatën për të gjitha gabimet dhe lëshimet që janë bërë nga ATK. Më tutje i ka propozuar gjykatës që mundësisht të kërkojë nga e paditura që të angazhojë inspektorë dhe një herë të bëjë kontrollimin e 40 aparateve të cilët kanë qenë rezervë dhe të papërdorshëm dhe mundësisht të angazhojë një ekspert të kësaj lëmie për aparatet e lojërave të fatit që do të jep mendimin e tij që këto 40 aparate që kanë qenë në depo nuk kanë qenë funksionale në kohën kur është bërë kontrolli dhe rikontrolli. Gjykatës i ka propozuar që të aprovohet kërkesëpadia si e bazuar dhe të anulohet vendim nr.66/2021 i datës 24.03.2021 dhe lënda të kthehet në rishqyrtim. Shpenzimet e procedurës nuk i kërkon.

E paditura, në përgjigjen në padi të datës 14.06.2021 ka deklaruar se padinë e paditësit kundër vendimit të DA/ATK-së, e konteston në tërësi si të pa bazuar dhe konsideron se vendimi i DA/ATK-së, si palë e paditur në këtë konflikt administrativ është i drejtë dhe i bazuar në ligj. Përfaqësuesi i palës paditëse në seancën e datës 02.04.2024 ka deklaruar se ATK në këtë rast ka vepruar sipas autorizimit nga Prokuroria Speciale dhe pas analizimit të dhënave nga Policia e Kosovës – Divizioni i Lojërave të Fatit dhe Hetuesia Tatimore ka rezultuar edhe qarkullimi shtesë. Ka theksuar se shitjet shtesë janë marrë nga gjendja e deklaruara sipas paditësit duke

krahasuar me numrat e aparateve nga verifikimi dhe analiza e tyre, Policia e Kosovës në bashkëpunim me zyrtarët tatimor me datë 03.03.2020 ka kryer regjistrimin e aparateve dhe është konstatuar saktë se në depo janë 81 aparate dhe një ruletë, nga të gjitha këto 63 aparate janë vlerësuar nga hetuesia tatimore që nënkupton është kalkuluar qarkullimi që është cekur më herët ndërsa për 18 mjete nuk ka pasur të dhëna apo kanë qenë të dëmtuara. Andaj ka shtuar se pretendimi me gjendjen e numrave nuk është i bazuar sepse divizioni i lojërave të fatit ka analizuar gjendjen e numrave në vend ngjarje dhe krahasimin e gjendjes së numrave IN dhe OUT me datë 03.03.2020. Ndërsa sa i përket numrave serik të aparaturës dhe numrave mekanik ka theksuar se është vërtetuar se paditësi ka duplikuar aparatet me numrat serik 3145400522 dhe aparat me numër serik 30988300457. Në fund ka konstatuar se nuk kanë bazë pretendimet e paditësit sepse ka pas verifikim dhe analizë dhe ky verifikim është kryer në prezencë të përfaqësuesit të paditësit me ç ‘rast është regjistruar nënshkrimi i aparateve, andaj mbështetur në vërtetimin e gjendjes faktike në teren dhe në interpretimin e drejtë të dëshmimeve të siguruara në shkresa të lëndës ATK konsideron se vendimi i atakuar është i drejtë dhe i bazuar në ligj, ndërsa argumentet e parashtruara nga paditësi nuk janë të mjaftueshme për të ndryshuar njoftim rivlerësimet apo për ta kthyer sërish lëndën në rishqyrtim dhe rivendosje. Shpenzimet e procedurës nuk i kërkon.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit gjyqësor kryesor - publik të datës 02.04.2024, ka administruar provat dhe atë: Vendimi 66/2021 datës 02.04.2021, Ankesë e datës 08.02.2021, Raport i kontrollit datës 06.01.2021, Lista e verifikimit të automjeteve në depo të biznesit, Vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve, Email i datës 25.03.2021, Aktgjykim A.nr. 233/2020, Vendim i ATK-së nr. 91/2022, Raport informues i datës 16.11.2020 dhe listë e verifikimit të automjeteve në depo të biznesit .

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues, thënieve në padi, përgjigjes në padi, shkresave të lëndës në këtë kontest tregtar administrativ, bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave se bashku, mbështetur edhe në dispozitat nga neni 8, i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), dhe arriti në përfundimin se në këtë konflikt administrativ, duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Nga provat e administruara në këtë kontest tregtar administrativ, deklarimeve në padi dhe përgjigje padi, shkresat e lëndës, vendimi kontestues, dhe deklarimit në seancën e shqyrtimit gjyqësor, Gjykata ka gjetur se nuk është kontestuese fakti se e paditura ka caktuar kontroll tek

paditësi, me ç' rast objekti i kontrollit ka qenë Tatimi në të Ardhurat e Korporatave CD periudha 2019, TVSH-ë periudha 2019 dhe WR periudha 2019, ku është konstatuar gjendja duke i marr për bazë informatat e dorëzuara nga DHTI-ja për vlerësim në bazë të cilave rezultoi me kontroll qarkullimi dhe tatimi shtesë. Jo kontestuese mbesin edhe faktet se paditësi me datë 08.02.2021 ka ushtruar ankesë ndaj Draft Raportit të ri të kontrollës, për të cilën ankesë ATK-ja me datë 02.04.2021 ka sjell vendimin nr.66/2021, si akt administrativ përfundimtar i nxjerrë në procedurën administrative në shkallë të dytë, me të cilin ka refuzuar ankesën e këtui paditësit, e ndaj të cilin vendim paditësi me padinë e datës 27.05.2021 ka iniciuar këtë kontest tregtar administrativ.

Gjykata konstaton se vendimi i kontestuar sa i përket ngarkimit me tatimit shtesë për periudhën e kontrollit lidhur me atë se tek tatimpaguesi gjatë aksionit të zhvilluar nga PK-ja është konstatuar diferenca (shitje shtesë) prej 841,816.11 €, sipas dokumentacionit në dosje, po sipas dispozitave ligjore nuk përmban arsye mbi faktet vendimtare, të vlefshme për zgjidhjen e drejtë të çështjes në shqyrtim. Në fakt në vendimin e kontestuar por edhe në raportin e kontrollit nuk është vërtetuar drejtë gjendja faktike sikurse edhe nga faktet e vërtetuara është nxjerr konkluzion jo i drejtë në pikëpamje të gjendjes faktike.

Gjykata vëren se e paditura në vendimin kontestues nuk i ka trajtuar pretendimet ankimore të paditësit dhe se e paditura nuk i ka verifikuar të njëjta lidhur me numrin mekanik të aparaturës dhe numrit serik të aparaturës, dhe nuk e ka vërtetuar saktë gjendjen faktike lidhur me numrat real mekanik IN dhe OUT të këtyre aparateve, po ashtu nuk e ka bërë përlllogaritjen e detyrimeve tatimore për paditësin. E paditura në vendimin kontestues vetëm ka përshkruar se janë marr diferencat e gjendjes së numrave IN dhe OUT në fund të korrikut/2018 dhe diferenca e gjendjes së numrave mekanik IN mekanika OUT të datës 03.03.2020 të verifikuara nga DHTI-ja që ka rezultuar me një ndryshim e cila është trajtuar me qarkullim shtesë. Po ashtu në vendimin kontestues vetëm ka cekur se Divizioni i Ankesave pas analizimit të dokumentacionit në dosje e në veçanti “Vërtetimin Mbi Sekuestrimin të Përkohshme të Sendeve” vjen në përfundim se me datë 03.03.2020 Polica e Kosovës e ka bërë regjistrimin e aparateve, të cilët kanë konstatuar se në depon gjenden 81 aparate dhe një Roulet. Gjykata propozimin e paditësit për dëgjimin e dëshmitarit si dhe për angazhimin e një eksperti me qëllim të vërtetimit nëse 40 aparatet kontestuese kanë qenë funksionale, e refuzoi si të pabazuar meqenëse i njëjti propozim nuk ishte qartësisht i bazuar dhe se vëllimi i detyrave të ekspertit nuk ishte i arsyetuar mjaftueshëm, kjo për faktin se nuk ishte kontestuese se disa prej aparateve ishin jashtë funksionit, që vërtetohet edhe nga vet vendimi kontestues.

Në procedurën e kontestit tregtar administrativ gjyqësor, Gjykata duke qenë se bazuar në dispozitën nga neni 44, par 1, i LKA-së, ku është përcaktuar qartë se Ligjshmëria e aktit administrativ të kontestuar shqyrtohet nga gjykata brenda kufijve të kërkesës nga Padia dhe pasi që gjykata ka shqyrtuar gjithë dokumentacionin e lëndës konstaton se nga konkluzionet e nxjerra në procedurën administrative dhe provave të theksuara në arsyetimet e vendimit të të paditurës, sa i përket konstatimit lidhur me numrat mekanik dhe pretendimit se janë bërë gabime teknike me rastin e shënimit të numrave serik të aparaturës, nuk është vërtetuar saktë gjendja faktike, ekzistojnë kontradikta në mes konstatimeve të cekura duke mos i arsyetuar mjaftueshëm me prova konkrete. E paditura duhet të vërtetoj faktin nëse me të vërtetë 40 aparate janë në pronësi të subjektit “Mercur Sport” siç ka pretenduar paditësi, dhe se arsyetimi se vetëm është konstatuar nga Vërtetimi mbi sekuestrim të përkohshëm të sendeve, për gjykatën është i pamjaftueshëm, kjo për faktin se e paditura nuk ka vërtetuar pronësinë e aparateve në fjalë e që mund të bëhet nëse krahasohen numrat e aparateve me subjektin “Mercur Sport”, të cilin e paditura duhet ta ketë.

Gjykata vendos për çështjen e kontestit tregtar administrativ në bazë të fakteve të vërtetuara në procedurë administrative, në vështrim të nenit 43 paragrafi 1 të LKA-së. Duke pasur parasysh konstatimet e lartcekura, gjykata konkludon se në këtë kontest tregtar administrativ ekzistojnë të meta të cilat pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë për arsye se në vendimin kontestues nuk janë dhënë arsye të bazuara dhe nuk është vërtetuar saktë gjendja faktike lidhur me numrat real mekanik, dhe nuk është bërë në përlllogaritje e saktë e detyrimit tatim për paditësin, për periudhën e kontrollit.

Gjykata kërkon nga e paditura të konstatoj drejtë dhe saktë gjendjen faktike lidhur me pretendimin e paditësit se gjatë evidentimit të aparateve inspektorët kanë lexuar gabim dy numra dhe të vërtetoj listën e verifikimit të automatëve më depon e biznesit, dhe pas analizimit të “Vërtetimit mbi Sekuestrimin e Përkohshëm të Sendeve” të vërtetohet sa aparate kanë qenë në posedim, dhe a ka pasur aparate të duplikuar. Gjithashtu e paditura ne rivendosje duhet të deklarohet lidhur me çështjet e ngritura si më lartë dhe të analizoj saktë se a janë përshkruar në raport dy herë të njëjta aparate dhe mbi bazën e këtyre të marr vendim meritor në këtë çështje.

Andaj të metat e cekura më lartë pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit të kontestuar dhe, në këtë drejtim gjykata e obligon të paditurën që në riprocedurë të veprojnë sipas vërejtjeve të dhëna në këtë aktgjykim, dhe pasi t’i mënjanojë këto të meta të merr vendim të drejtë dhe të bazuar në ligj.

Gjykata vendos për çështjen e kontestit tregtar administrativ në bazë të fakteve të vërtetuara në procedurë administrative, dhe në vështrim të neneve 43, paragrafi 1, dhe 44, paragrafi 1, të LKA-se. Në bazë të këtij parimi, Gjykata Ligjshmërinë e aktit administrativ të kontestuar e shqyrton brenda kufijve të kërkesës nga padia, andaj edhe e ka të pamundur të vendos në mënyrë meritore në këtë kontest tregtar administrativ, andaj e aprovon padinë e paditësit, anulon vendimin e kontestuar, dhe lënda kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje. Gjykata bazuar në autorizimet nga neni 43 par.2 të LKA-së e detyron të paditurën, që në ri procedure të veproj sipas vërejtjeve të dhëna në arsyetim të këtij aktgjykimi.

Vërejtjet e cekura janë të obligueshme për organin e paditur, edhe duke u bazuar në nenin 65, të Ligjit për Konfliktet Administrative.

Vendimin që secila palë ti bartë shpenzimet e procedurës, Gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 64 të LKA-së nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative.

Nga sa u tha më lartë, gjykata në pajtim me dispozitat ligjore të nenit 43 par.2, dhe 46 par 1, 2 dhe 3, të LKA-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal

KF.nr.325/22, datë 02.04.2024

Gjyqtarja

Vera Gashi Bala

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, dhomave të shkallës së dytë, përmes dhomave të shkallës së parë të kësaj Gjykate.